



Në bazë të Nenit 14, pika 2 të Ligjit për Varrezat dhe Shërbimet e Varrimit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 86/08, 156/10, 53/11, 163/13, 152/15 dhe 31/16 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" numër 255/24 dhe 101/25), dhe në lidhje me Nenin 10 paragrafi 4 të Ligjit për Qytetin e Shkupit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 55/04, 158/11), Qyteti i Shkupit shpall:

KONKURS PUBLIK për zgjedhjen e drejtuesit të varrezave

1. Qyteti i Shkupit kryen zgjedhjen e drejtuesit të varrezave të qytetit Butel, Gjorçe Petrov dhe Kamnik, të përcaktuar me planin urbanistik;
2. Drejtuesi i varrezave, i përcaktuar në pikën 1 zgjidhet për një mandat 4 (katër) vjeçar;
3. Të drejtë për pjesëmarrje në Konkursin publik kanë të gjithë personat juridikë të cilët posedojnë Leje për menaxhim me varrezat, të lëshuar nga Ministria për Transport dhe Lidhje;
4. Së bashku me aplikimin, personat juridikë duhet të depozitojnë Leje për menaxhimin me varrezat në origjinal ose kopje të noterizuar;
5. Afati për depozitim të aplikimit për menaxhimin me varrezat është 8 (tetë) ditë, llogaritur nga dita e shpalljes së konkursit;
6. Dokumentacioni i depozituar me vonesë, i pakompletuar dhe i parregullt, nuk do të jetë lëndë e shqyrtimit.

Personat juridikë janë të detyruar aplikimet t'i depozitojnë në adresën e mëposhtme:

QYTETI I SHKUPIT – KRYETARI I QYTETIT TË SHKUPIT
(me shenjë: për konkursin publik për menaxhimin me varrezat)
Bul. "Ilinden" nr. 82 - Shkup

QYTETI I SHKUPIT
KRYETARI,
Orce Gjorgjievski